LIGJ
Nr. 13/2015

PËR POLICINË USHTARAKE NË FORCAT E ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

(ndryshuar me ligjin nr. 61/2022, datë 21.7.2022)

(i përditësuar)

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Objekti i këtij ligji është përcaktimi i misionit, statusit, organizimit, përgjegjësive dhe detyrave të Policisë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Neni 2
Misioni
(zëvëndësuar fjalë me ligjin nr. 61/2022, datë 21.7.2022)

Misioni i Policisë Ushtarake është ruajtja e rendit ushtarak, garantimi i zbatimit të ligjit nga veprimtaritë e kundërligjshme në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë, mbrojtja e jetës së personelit, mbështetja për mbrojtjen e pronës dhe të pasurisë shtetërore në administrim dhe përdorim të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Forcave të Armatosura, angazhimi në luftën kundër terrorizmit dhe pjesëmarrja në operacionet paqeruajtëse e humanitare.

Neni 3
Juridiksioni
(shtuar fjalë me ligjin nr. 61/2022, datë 21.7.2022)

Policia Ushtarake e ushtron juridiksionin e saj në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe kur dërgohet me mision, shërbim stërvitje ose në mbështetje të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, jashtë vendit.

Neni 4
Statusi
(shtuar fjalë me ligjin nr. 61/2022, datë 21.7.2022)

Policia Ushtarake është strukturë e specializuar për veprimet policore në përbërje të Forcave të Armatosura, në varësi të Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Neni 5
Parimet

Parimet bazë, në bazë të të cilave udhëhiqet Policia Ushtarake në veprimtarinë e saj, janë:
a) ligjshmëria;
b) mosdiskriminimi;
c) respektimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut;
ç) proporcionaliteti;
d) pavarësia operacionale;
dh) integriteti, merita dhe profesionalizmi;
e) transparenca;
ë) ruajtja e informacionit të klasifikuar;
f) kontrolli dhe llogaridhënia.

Neni 6
Përkufizime

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. "Punonjës i Policisë Ushtarake" është shtetasi shqiptar, ushtarak ose civil, që shërben në Policinë Ushtarake.

2. "Informacion" është çdo njohuri që mund të komunikohet apo të dokumentohet, pavarësisht nga forma, që është nën kontrollin e Policisë Ushtarake.

3. "Përdorimi i forcës" është veprimi i drejtpërdrejtë i punonjësit të Policisë Ushtarake nëpërmjet forcës fizike, pajisjeve apo mjeteve të tjera, të dhëna në përdorim, në bazë dhe për zbatim të ligjit.

4. "Shoqërimi" është dërgimi i personit në ambientet e Policisë Ushtarake, me ose pa vullnetin e tij, për shkaqe të parashikuara në këtë ligj.

5. "Veprimtari informative" është veprimtaria e punonjësit të Policisë Ushtarake, e kryer në përputhje me legjislacionin në fuqi për kërkimin, gjetjen, grumbullimin, administrimin, verifikimin, analizimin e të dhënave dhe informacioneve për veprimtari të kundërligjshme në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

6. "Fondi operativ" është pjesa e buxhetit të Policisë Ushtarake që përdoret në funksion të veprimtarive operative.

Neni 7
Fusha e veprimit
(shtuar fjalë me ligjin nr. 61/2022, datë 21.7.2022)

Veprimtaria e Policisë Ushtarake ushtrohet mbi të gjitha subjektet ushtarake e civile, vendase dhe të huaja, me ose pa shtetësi, të cilat, me veprimet ose mosveprimet e tyre, cenojnë veprimtarinë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë brenda e jashtë vendit dhe mbështetet në dispozitat e këtij ligji dhe në legjislacionin në fuqi.

KREU II

ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E POLICISË USHTARAKE

Neni 8
Organizimi

Policia Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë është e organizuar në bazë reparti, nënreparti, sektori, inspektorati, shërbimi, seksioni dhe nënseksioni.

Neni 9
Rendi ushtarak

Në Policinë Ushtarake organizohet dhe funksionon seksioni i rendit ushtarak, i cili siguron dhe kontrollon zbatimin e akteve ligjore e nënligjore për rendin dhe disiplinën ushtarake në kuadrin e veprimtarisë së Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Neni 10
Policia Kriminale Ushtarake
(shfuqizuar pika 4 me ligjin nr. 61/2022, datë 21.7.2022)

1. Në Policinë Ushtarake organizohet dhe funksionon Policia Kriminale Ushtarake, si organ i specializuar për parandalimin, zbulimin, ndjekjen e veprimtarisë kriminale, kapjen e personave që kanë kryer ose përgatiten të kryejnë vepra penale ndaj Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

2. Për sigurimin e informacionit të nevojshëm, gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, Policia Kriminale Ushtarake shfrytëzon burime njerëzore, dokumente, mjete teknike e elektronike, mbikëqyrje të fshehtë, si dhe krijon bazë të dhënash të veçantë për personat që kanë kryer apo janë të dyshuar për kryerjen e një vepre penale.

3. Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së saj, Policia Kriminale, me atributet e Policisë Gjyqësore, kryen veprimtari procedurale në fazat e procedimit penal, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

4. Shfuqizuar.

Neni 11
Shërbimi i Policisë Gjyqësore
(ndryshuar emërtimi i nenit dhe pika 1 me ligjin nr. 61/2022, datë 21.7.2022)

1. Shërbimi i Policisë Gjyqësore në Policinë Ushtarake është struktura përgjegjëse, e cila ushtron detyrat e saj në përputhje me legjislacionin në fuqi për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore dhe Kodin e Procedurës Penale.

2. Policia Gjyqësore në Policinë Ushtarake kryen veprimtari procedurale përgjatë të gjitha fazave të procedimit penal, të urdhëruara apo të deleguara nga organi procedues ose me nismën e vet, në përputhje me legjislacionin procedural në fuqi.

3. Policia Gjyqësore në Policinë Ushtarake kryen të njëjtat funksione të parashikuara në ligjin për Policinë Gjyqësore.

Neni 11/1
(shtuar me ligjin nr. 61/2022, datë 21.7.2022)

Subjektet që ushtrojnë funksionet e Policisë Gjyqësore në Policinë Ushtarake janë:

a) oficerët e Policisë Gjyqësore në Policinë Ushtarake, drejtuesit dhe inspektorët e strukturave në Policinë Kriminale, në Qarkullimin Rrugor dhe Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin, që përmbushin kriteret sipas ligjit;

b) agjentët e Policisë Gjyqësore në Policinë Ushtarake, agjentët e strukturave në Policinë Kriminale, specialistët në strukturën e Qarkullimit Rrugor dhe në Inspektoratin e Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimin.

Neni 12
Qarkullimi rrugor

Për organizimin, sigurimin dhe kontrollin e trafikut ushtarak, organizohet Struktura e Qarkullimit Rrugor, e cila e ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin në fuqi për qarkullimin rrugor.

Neni 13
Inspektorati për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin

Në strukturën e Policisë Ushtarake organizohet dhe funksionon Inspektorati për Mbrojtjen nga Zjarri dhe Shpëtimin. Ky inspektorat e kryen veprimtarinë në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen nga zjarri dhe shpëtimin.

Neni 14
Shenjat dhe simbolet e Policisë Ushtarake

1. Punonjësi ushtarak mban shenjat dalluese dhe simbolet, të cilat përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes.

2. Për shkak të natyrës së punës, për realizimin e detyrës funksionale, punonjësi ushtarak përdor edhe veshje civile.

3. Punonjësi i Policisë Ushtarake pajiset dhe mban dokument specifik identifikimi, të cilin e paraqet gjatë kryerjes së detyrës.

Neni 15
Mjetet lëvizëse të Policisë Ushtarake

Në ushtrimin e detyrave, Policia Ushtarake përdor mjete lëvizëse. Ngjyra dhe shenjat dalluese përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 16
Burimet financiare

1. Policia Ushtarake ka buxhetin e vet, brenda buxhetit të miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

2. Buxheti i Policisë Ushtarake parashikon edhe fond operativ.

3. Përdorimi dhe kontrolli i fondit operativ rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes.

KREU III

PËRGJEGJËSITË E POLICISË USHTARAKE

Neni 17
Marrja e kallëzimit

Oficeri i Policisë Ushtarake, që gëzon atributet e Policisë Gjyqësore, merr kallëzim për veprat penale që cenojnë ose mund të cenojnë Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale, vendos dokumentacionin përkatës në dispozicion të prokurorit që ka në kompetencë ushtrimin e ndjekjes penale.

Neni 18
Veprimtaria informative

1. Veprimtaria informative në Policinë Ushtarake realizohet nëpërmjet procesit të grumbullimit, sistemimit, vlerësimit, analizimit, shpërndarjes dhe përdorimit të informacionit për nevoja të parandalimit e zbulimit të autorëve të veprave penale ose për nevoja të mbrojtjes së rendit ushtarak.

2. Veprimtaria informative bazohet vetëm në të dhënat e marra në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Rregullat për realizimin dhe kontrollin e veprimtarisë informative, si dhe për ruajtjen e të dhënave miratohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të Mbrojtjes dhe Prokurorit të Përgjithshëm.

Neni 19
Mbledhja dhe përpunimi i të dhënave personale

1. Policia Ushtarake mbledh dhe përpunon vetëm të dhënat personale që janë të nevojshme për ndalimin e një rreziku real ndaj rendit ushtarak, si dhe për parandalimin, zbulimin, ndjekjen e hetimin e veprave penale të kryera në Forcat e Armatosura, në përputhje me Kodin e Procedurës Penale.

2. Të dhënat personale dhe sensitive, të mbledhura për qëllime të këtij ligji, ruhen në dosje të veçanta dhe përdoren vetëm për këtë qëllim, në përputhje me dispozitat e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale.

3. Të dhënat personale dhe sensitive, të ruajtura për qëllime të këtij ligji, evidentohen me një shenjë që tregon besueshmërinë dhe saktësinë e tyre. Për këtë qëllim, miratohet dhe zbatohet një sistem kodimi, i përcaktuar me udhëzim të Ministrit të Mbrojtjes.

4. Çdo person, civil ose ushtarak, ka të drejtë të ankohet në rast se vlerëson se Policia Ushtarake ka shkelur të drejtat e tij për mbrojtjen e të dhënave personale dhe sensitive, në kundërshtim me dispozitat e këtij ligji dhe legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale.

5. Përpunimi i të dhënave kryhet për aq kohë sa është i nevojshëm për qëllimin, për të cilin është grumbulluar.

6. Rregullat për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave personale përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Mbrojtjes.

Neni 20
Bashkëpunimi me individët

1. Policia Kriminale Ushtarake, për të siguruar informacionin, bashkëpunon edhe me individë brenda dhe jashtë Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

2. Punonjësi i Policisë Kriminale Ushtarake dhe personi që vendos marrëdhënie të fshehta bashkëpunimi detyrohen të ruajnë sekretin e bashkëpunimit, të informacioneve, të fshehtësisë së identitetit dhe të rrethanave të tjera, sipas legjislacionit në fuqi.

3. Procedurat e bashkëpunimit me individë miratohen me udhëzim të përbashkët të Ministrit të

Mbrojtjes dhe Prokurorit të Përgjithshëm.

Neni 21

Njoftimi për paraqitje në Policinë Ushtarake

(shtuar shkronja "ç" e pikës 1 me ligjin nr. 61/2022, datë 21.7.2022)

1. Ushtaraku ose civili që punon në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë njoftohet nëpërmjet titullarit të strukturës ushtarake për t'u paraqitur në zyrat e Policisë Kriminale Ushtarake në këto raste:

a) për të marrë informacion në lidhje me parandalimin e veprimit ose për raste të mosveprimit, që përbën vepër penale;

b) për të identifikuar personin që mund të ketë dijeni për rrezikun apo veprën penale;

c) për të identifikuar shkelësin e mundshëm të ligjit.

ç) për të dhënë deklarime për rrethanat e ngjarjes sipas parashikimeve në Kodin e Procedurës Penale.

2. Njoftimi për paraqitje bëhet me anë të fletënjoftimit, duke përcaktuar arsyen e paraqitjes, punonjësin e Policisë Ushtarake, kohën, vendin dhe informacionin për të kontaktuar punonjësin e Policisë Ushtarake në rast pamundësie për t'u paraqitur.

3. Kur, për shkak të kushteve personale dhe familjare, personi që njoftohet nuk mund të paraqitet në zyrat e Policisë Ushtarake, punonjësi i Policisë Ushtarake mund ta marrë këtë informacion në vendbanimin e personit të njoftuar.

Neni 22

Hyrja në mjedise

1. Punonjësi i Policisë Ushtarake ka të drejtë të hyjë në mjediset e reparteve e të institucioneve ushtarake vetëm:

a) kur ka të dhëna të bazuara se është duke u kryer një krim;

b) për kapjen e autorëve të një krimi, të cilët janë fshehur në këto mjedise;

c) për të dhënë ndihmën e nevojshme në raste aksidentesh, zjarresh e fatkeqësish natyrore.

2. Punonjësi i Policisë Ushtarake ka të drejtë të hyjë në objektet e mbyllura dhe në zyrat e komandave me kërkesë të këtyre të fundit ose në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

Neni 23

Kontrolli i mjediseve

1. Kontrolli në mjediset, ku ushtrojnë veprimtarinë Forcat e Armatosura ose që lidhen me veprimtarinë e tyre, kryhet në përputhje me dispozitat përkatëse të Kodit të Procedurës Penale.

2. Në rast flagrance ose në rast ndjekjeje të personit që është duke ikur, kur nuk lejohet nxjerrja e një vendimi kontrolli, oficerët e Policisë Gjyqësore kryejnë kontrollin e personit ose të vendit, duke zbatuar dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

3. Punonjësit e Policisë Ushtarake bllokojnë pjesë të rrugëve, zyra e mjedise, ku ka ndodhur vepra penale, për ruajtjen e vendit të ngjarjes dhe të provave materiale deri në ardhjen e Policisë Gjyqësore ose të prokurorit, sipas legjislacionit në fuqi.

Neni 24

Kontrolli i identitetit

1. Punonjësi i Policisë Ushtarake i kërkon ushtarakut ose civilit që të paraqesë dokumentin e identifikimit, në rastet kur:

a) është i pranishëm ose në afërsi të drejtpërdrejtë me vendngjarjen apo kur është dëshmitar i mundshëm i veprës penale;

b) ekzekutohet një urdhër i organeve përkatëse;

c) kërkohen personat e dyshuar për cenim të rendit ushtarak;

ç) për rrethana të kohës dhe vendit dyshohet se ushtaraku ose civili është përfshirë në veprime të jashtëligjshme;

d) vepron në kundërshtim me rregulloret ushtarake.

2. Për një identifikim të besueshëm të personit, punonjësi i Policisë Ushtarake bazohet në dokumentin specifik të identifikimit, të miratuar, përkatësisht, nga Ministri i Mbrojtjes, komandat e forcave ose reparteve e të ndërmarrjeve ushtarake, ose në dokumentin ligjor të identifikimit.

Neni 25

Kontrolli i personit

1. Kontrolli i ushtarakut ose civilit për kryerjen e një vepre penale në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë ushtrohet në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

2. Policia Ushtarake bën kontrolle, sekuestron prova materiale dhe ndalon personin në kushtet e flagrancës së kryerjes së një vepre penale, në përputhje me dispozitat e Kodit të Procedurës Penale.

3. Kontrollet kryhen nga punonjës policie të së njëjtës gjini me personin e kontrolluar.

Neni 26

Mjediset e punës

Punonjësve të Policisë Ushtarake u krijohen kushte dhe mjedise pune të përshtatshme për kryerjen e detyrës së tyre funksionale brenda njësive e reparteve nga komandat e forcave dhe drejtuesit e strukturave ushtarake.

Neni 27

Shoqërimi në Policinë Ushtarake

1. Punonjësi i Policisë Ushtarake shoqëron në zyrat e Policisë Ushtarake në qendrat e reparteve apo të institucionit ushtarak ushtarakët:

a) që refuzojnë të paraqesin dokumentin e identifikimit;

b) për të cilët dyshohet për vërtetësinë e dokumentit të tij të identifikimit;

c) që kundërshtojnë ose pengojnë punonjësin e Policisë Ushtarake në kryerjen e detyrës;

ç) që janë gjendur në vendngjarje dhe për të cilët dyshohet se janë autorë të veprës penale;

d) që kërkohen nga organet e drejtësisë.

2. Punonjësi i Policisë Ushtarake shoqëron në zyrat e Policisë Ushtarake në qendrat e reparteve apo të institucionit ushtarak civilët që, brenda mjediseve ushtarake:

a) refuzojnë të paraqesin dokumentin e identifikimit;

b) për të cilët dyshohet për vërtetësinë e dokumentit të tij të identifikimit;

c) kundërshtojnë ose pengojnë punonjësin e Policisë Ushtarake në kryerjen e detyrës;

ç) janë gjendur në vendngjarje dhe për të cilët dyshohet se janë autorë të veprës penale.

3. Personit, që shoqërohet nga Policia Ushtarake, i krijohen kushte normale qëndrimi dhe, pas sqarimit të rrethanave të çështjes për të cilën është shoqëruar, kur nuk është i implikuar, lihet i lirë. Në të

gjitha rastet, personi i shoqëruar nuk mund të mbahet më shumë se 10 orë.

Neni 28

Arrestimi dhe ndalimi

Punonjësi i Policisë Ushtarake bën arrestimin dhe ndalimin e ushtarakut ose civilit sipas dispozitave të Kodit të Procedurës Penale.

Neni 29

Të dhënat në rastet e shoqërimit, ndalimit dhe arrestimit

(shtuar fjalë në shkronjën "b" të pikës 1 me ligjin nr. 61/2022, datë 21.7.2022)

1. Për të regjistruar të dhënat e personit të dyshuar për kryerjen e një vepre penale, punonjësi i Policisë Ushtarake kryen këto veprime:

a) Në rast shoqërimi, punonjësi i Policisë Ushtarake evidenton për çdo person të shoqëruar të dhënat për:

i) gjenealitetet;

ii) vendbanimin;

iii) përshkrimin e pamjes së personit, përfshirë shenja të veçanta;

iv) gradën dhe detyrën që kryen;

v) arsyet e shoqërimit;

vi) orën, datën dhe vendin e shoqërimit;

vii) punonjësin e Policisë Ushtarake, i cili ka kryer shoqërimin.

b) Në rast arrestimi apo ndalimi, punonjësi i Policisë Ushtarake evidenton për çdo person të arrestuar apo të ndaluar si dhe i dërgon në Policinë e Shtetit të dhënat për:

i) gjenealitetet;

ii) vendbanimin;

iii) përshkrimin e pamjes së personit, përfshirë shenja të veçanta;

iv) gradën dhe detyrën që kryen;

v) veprën penale, për të cilën është arrestuar apo ndaluar;

vi) hollësi për mënyrën e kryerjes së veprës penale, për të cilën është arrestuar apo ndaluar;

vii) orën, datën dhe vendin e arrestimit apo të ndalimit;

viii) punonjësin e Policisë Ushtarake, i cili ka kryer arrestimin apo ndalimin.

c) Për çdo person të arrestuar apo të ndaluar, në çdo rast, punonjësi i Policisë Ushtarake merr të dhënat e mëposhtme:

i) shenjat e gjurmëve të gishtave dhe të pëllëmbëve të duarve;

ii) dy fotografi, një pamje ballore dhe një profil.

2. Të dhënat e parashikuara në nënndarjen "ii", përkatësisht, të shkronjave "a" dhe "b", të pikës 1, të këtij neni, evidentohen në sistemin TIMS nga punonjësi i Policisë Ushtarake.

Neni 30

Përdorimi forcës

Punonjësi i Policisë Ushtarake përdor forcën, mjetet dhe pajisjet e tjera speciale, të dhëna në përdorim, në bazë dhe për zbatim të ligjit, kur kundërshtohet ose pengohet gjatë kryerjes së detyrës:

a) ndaj personit që përpiqet të lirojë personin e shoqëruar;

b) nëse i ndaluari, i arrestuari ose personi që shoqërohet bën përpjekje të largohet forcërisht;

c) për të vendosur rendin ushtarak, të cenuar nga veprime të pakontrolluara të personelit të

Forcave të Armatosura.

Neni 31
Mënyra e përdorimit të forcës

1. Punonjësi i Policisë Ushtarake përdor forcën për të përmbushur një qëllim të ligjshëm vetëm kur kjo është e nevojshme dhe nëse të gjitha masat e tjera janë të pasuksesshme apo të pamundura. Punonjësi i Policisë Ushtarake përdor nivelin minimal të forcës së nevojshme, në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

2. Punonjësi i Policisë Ushtarake përzgjedh nivelin e nevojshëm të forcës ndërmjet mundësive të përshkallëzuara ku, ndër të tjera, përfshihen bindja me fjalë, shtrëngimi fizik, mjetet goditëse, mjetet me goditje elektrike dhe armët e zjarrit.

3. Të dëmtuarit i jepet ndihmë, ku përfshihet edhe ajo mjekësore, pas përdorimit të forcës, në rast se kjo është e nevojshme dhe e mundur.

4. Punonjësi i Policisë Ushtarake duhet të paralajmërojë se do të përdorë forcën para përdorimit të saj. Ky paralajmërim mund të mos kryhet nëse rrethanat nuk e lejojnë, veçanërisht kur përdorimi i menjëhershëm i forcës është i nevojshëm për të parandaluar një rrezik real dhe të çastit.

Neni 32
Përdorimi i armëve të zjarrit

Punonjësi i Policisë Ushtarake përdor armët e zjarrit që ka në përdorim në rastet dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi për përdorimin e armëve të zjarrit.

KREU IV
DETYRAT E POLICISË USHTARAKE

Neni 33
Detyrat
(ndryshuar shkronja "f", shtuar fjalë në shkronjën "k", ndryshuar shkronja "n" me ligjin nr. 61/2022, datë 21.7.2022)

Policia Ushtarake, në përmbushje të misionit të saj, ka këto detyra:

a) mbron jetën, shëndetin dhe dinjitetin e ushtarakut nga çdo veprim i paligjshëm, kur ato cenohen për shkak të detyrës;

b) merr masa për zbatimin e akteve ligjore e nënligjore për rendin dhe disiplinën ushtarake jashtë strukturave ushtarake në mjediset publike dhe jopublike;

c) me kërkesë të komandave dhe të drejtuesve të institucioneve ushtarake, ndërhyn në repartet ushtarake për parandalimin dhe mënjanimin e veprimeve të kundërligjshme që kanë të bëjnë me prishjen e rendit ushtarak;

ç) siguron rendin ushtarak në kuadër të veprimtarive të organizuara në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë;

d) merr masa për parandalimin, zbulimin dhe ndjekjen e veprimtarisë kriminale ndaj pjesëtarëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, pronës e objekteve ushtarake;

dh) bën hetimin e veprave penale të kryera në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë;

e) merr masa për zbatimin e vendimeve të gjykatës dhe të akteve të Prokurorisë për personelin e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë;

ë) ndërhyn për të ndërprerë aktet e terrorizmit në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë;

f) mbështet mbrojtjen e pronës dhe të pasurisë shtetërore në administrim e në përdorim të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë nga veprimtari të kundërligjshme;

g) ndërhyn përkrah Policisë së Shtetit për të rivendosur rendin në rast të shpalljes së gjendjes së jashtëzakonshme, të krijuar si rezultat i kryerjes së veprave me qëllime terroriste dhe krimeve kundër autoritetit të shtetit;

gj) realizon, me urdhër të autoritetit epror, lirimin e pronave në administrim ose përdorim të Ministrisë së Mbrojtjes, të zëna forcërisht;

h) kryen detyra policore në interes të ushtarakëve shqiptarë që kryejnë misione jashtë vendit, si dhe forcave ushtarake të huaja, që veprojnë në territorin shqiptar, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

i) kryen funksionet e Policisë Ushtarake në operacionet ushtarake dhe paqeruajtëse jashtë vendit, në bazë të marrëveshjeve ndërkombëtare të ratifikuara;

j) kontrollon e siguron transportin, lëvizjen dhe shfrytëzimin e mjeteve dhe të teknikës ushtarake;

k) shoqëron e siguron personalitetet e larta ushtarake dhe civile të Ministrisë së Mbrojtjes dhe të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, delegacionet e huaja ushtarake të njësuara me to, si dhe forcat e huaja ushtarake që kalojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë;

l) mban nën kontroll rrjetin rrugor në zonat e operacioneve;

ll) jep masa administrative, sipas Kodit Rrugor të Republikës së Shqipërisë, për drejtuesit e mjeteve ushtarake që shkelin rregullat e qarkullimit rrugor në poligonet e stërvitjes dhe jashtë ambienteve ushtarake;

m) kryen ekspertizën autoteknike, në rastet e aksidenteve dhe incidenteve rrugore në teknikë ushtarake;

n) kontrollon masat parandaluese, jep asistencë teknike e ndërhyn për forcimin e masave dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga zjarri;

nj) mbështet kryerjen e operacioneve ku angazhohen Forcat e Armatosura, brenda dhe jashtë vendit;

o) Policia Ushtarake, në gjendje lufte, bën sigurimin e personelit, të materialeve dhe mjeteve luftarake, merr masa për grumbullimin, evakuimin, ruajtjen dhe sigurimin e robërve të luftës, si dhe të personelit civil të ndaluar.

Neni 34

Bashkëveprimi me strukturat e tjera

1. Në përmbushje të misionit dhe realizimit të detyrave, Policia Ushtarake bashkëvepron me strukturat e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, strukturat e inteligjencës ushtarake, Policinë e Shtetit, Shërbimin Informativ të Shtetit, prokurorinë, gjykatat, policitë e tjera të përcaktuara me ligj dhe me njësitë e qeverisjes qendrore dhe vendore, të përcaktuara me akte normative të përbashkëta.

2. Policia Ushtarake bashkëvepron me policitë ushtarake të vendeve aleate në operacionet brenda dhe jashtë vendit, në bazë të marrëveshjeve dy ose shumëpalëshe.

Neni 35

Shkëmbimi i informacionit

1. Policia Ushtarake shkëmben informacione me strukturat e tjera shtetërore, të përcaktuara në pikën 1, të nenit 34, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

2. Shkëmbimi i informacionit ndërmjet Policisë Ushtarake dhe strukturave ose organeve të tjera rregullohet me akte normative të përbashkëta të titullarëve të institucioneve përkatëse.

Neni 36

Detyrimi për të mos dhënë informacion

(shtuar pika 4 me ligjin nr. 61/2022, datë 21.7.2022)

1. Punonjësi i Policisë Ushtarake nuk duhet të japë informacion, për të cilin ka marrë dijeni gjatë kryerjes së detyrës ose jashtë saj, përveç personave të autorizuar me ligj.

2. Detyrimi për të mos dhënë informacion zbatohet edhe për punonjësin e Policisë Ushtarake të liruar ose të larguar nga Policia Ushtarake.

3. Për informacione, që kanë të bëjnë me identitetin e dëshmitarëve dhe informatorëve, Policia Ushtarake zbaton legjislacionin në fuqi.

4. Oficerët e Policisë Gjyqësore në Policinë Ushtarake dhe persona të tjerë që gëzojnë atributet e OPGJ-së, sipas përcaktimeve ligjore në fuqi të ngarkuara nga prokurori me hetimin e procedimeve penale, zbatojnë rregullat e legjislacionit në fuqi për ndalimin e publikimit të akteve, që dokumentojnë veprimtarinë procedurale penale dhe çdo informacion tjetër që rrjedh prej tyre.

KREU V
PRANIMI, EMËRIMI, KUALIFIKIMI, SHËRBIMI DHE TRAJTIMI I PUNONJËSIT TË POLICISË USHTARAKE

Neni 37
Pranimi, emërimi dhe karriera

1. Pranimi, emërimi dhe karriera e punonjësit ushtarak kryhen sipas kritereve të përcaktuara në legjislacionin në fuqi për karrierën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

2. Pranimi, emërimi dhe karriera e punonjësit civil kryhen në përputhje me legjislacionin në fuqi për punonjësit civilë në Forcat e Armatosura.

Neni 38
Trajnimi profesional i punonjësit të shërbimeve të Policisë Ushtarake
(shtuar paragraf në fund të pikës 1 me ligjin nr. 61/2022, datë 21.7.2022)

1. Punonjësi i shërbimeve të Policisë Ushtarake i nënshtrohet trajnimit profesional nga institucionet arsimore të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë ose jashtë tyre, të cilat ofrojnë trajnim në përputhje me ligjin.

Trajnimi fillestar i punonjësit të shërbimit në Policinë Ushtarake, që plotëson kriteret ligjore për pranimin në shërbimin e Policisë Gjyqësore, dhe trajnimi vazhdues i tij kryhen në zbatim të ligjit për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore.

2. Programet, kohëzgjatja dhe vendi i kryerjes së trajnimeve profesionale jashtë institucioneve arsimore të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë përcaktohen me akt normativ të përbashkët të Ministrit të Mbrojtjes dhe titullarit të institucionit që kryen trajnimin.

Neni 39
Rregullorja e brendshme e funksionimit dhe përgjegjësia disiplinore e punonjësit të Policisë Ushtarake
(zëvëndësuar fjalë në titullin e nenit, ndryshuar pika 1 me ligjin nr. 61/2022, datë 21.7.2022)

1. Gjatë përmbushjes së detyrave të caktuara me ligj, punonjësi i Policisë Ushtarake zbaton rregulloren e brendshme të funksionimit të Policisë Ushtarake, të miratuar me urdhër të ministrit të Mbrojtjes.

2. Procedimi disiplinor dhe masat disiplinore ndaj punonjësit të Policisë Ushtarake rregullohen

nga legjislacioni në fuqi për disiplinën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

3. Procedimi disiplinor dhe masat disiplinore ndaj punonjësit të shërbimeve të Policisë Ushtarake rregullohen nga legjislacioni në fuqi për disiplinën ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe legjislacioni për organizimin dhe funksionimin e Policisë Gjyqësore.

Neni 40

Sigurimi i jetës

Punonjësi i Policisë Ushtarake përfiton sigurim jete. Kategoritë e përfituesve, masat dhe kriteret përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Neni 41

Trajtimi i veçantë

(ndryshuar fjalë në pikën 3 me ligjin nr. 61/2022, datë 21.7.2022)

1. Kur punonjësi i Policisë Ushtarake vdes ose bëhet i paaftë për punë gjatë kryerjes së detyrës ose për shkak të detyrës, familja e tij ose ai vetë përfitojnë pension në masën e pagës së plotë që ka pasur në çastin që i ka lindur e drejta për këtë përfitim.

2. Kur punonjësi i Policisë Ushtarake, gjatë kryerjes së detyrës ose për shkak të saj, i dëmtohet prona, ai ka të drejtën e kompensimit. Masa dhe kriteret për kompensim përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Punonjësi i Policisë Ushtarake trajtohet me veshmbathje civile, në vlerë leku, një herë në vit, në masën e një page mujore sipas vendit të punës. Kriteret e përfitimit të veshmbathjeve civile përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Punonjësi i Policisë Ushtarake përfiton shtesë mbi pagë për kushte të veçanta pune dhe shërbimi. Masa e këtyre shtesave rregullohet sipas legjislacionit në fuqi.

5. Punonjësi i Policisë Ushtarake, përveç të drejtave të përcaktuara në këtë ligj, gëzon dhe të gjitha të drejtat e ushtarakut të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Neni 42

Mbrojtja e veçantë

Policia Ushtarake siguron mbrojtje të veçantë për punonjësin e Policisë Ushtarake, të cilit i kërcënohet jeta, familja dhe prona për shkak të detyrës. Kushtet dhe mënyra e mbrojtjes së veçantë përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

KREU VI

DISPOZITA TË FUNDIT

Neni 43

Nxjerrja dhe miratimi i akteve nënligjore

Ngarkohet për nxjerrjen e akteve nënligjore brenda 6 muajve:

a) Këshilli i Ministrave, në zbatim të neneve 14, pika 1; 15; 16, pika 3; 40; 41, pikat 2 dhe 3; dhe 42 të këtij ligji;

b) Ministri i Mbrojtjes, në zbatim të nenit 19, pikat 3 dhe 6, të këtij ligji;

c) Ministri i Mbrojtjes, në bashkëpunim me Prokurorin e Përgjithshëm, në zbatim të neneve 10, pika 4; 18, pika 3; dhe 20, pika 3, të këtij ligji.

Neni 44
Shfuqizimi i akteve

Ligji nr. 9069, datë 15.5.2003, "Për Policinë Ushtarake në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë", dhe çdo akt tjetër ligjor e nënligjor që vjen në kundërshtim me këtë ligj, shfuqizohen.

Neni 45
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 26.2.2015